



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Prot 24/34

Tiranë, më 07/03/2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT ALBAN DAUTAJ

Nr. 19, datë 01.03.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Enton Radovani	Kryesues
Kleada Mersinllari	Relatore
Edona Dushaj	Anëtare

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtare e Sekretariatit Teknik, znj. Ledjana Azemaj, në datën 22.02.2024 ora 10:30, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Z. Alban Saliko Dautaj, me funksion Drejtor, në Drejtorinë e Antiterrorit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi relatimin e relatores së çështjes Kleada Mersinllari; dëgjoi subjektin e vlerësimit, Alban Saliko Dautaj cili në seancën dëgjimore publike të datës 22.02.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Antiterrorit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në terësi duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar,





V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, shtetasi z. Alban Dautaj është subjekt i vlerësimit kalimtar nga trupat e vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit datë 05.04.2023, me pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Antiterrorit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.”
3. Subjekti i vlerësimit **z. Alban Dautaj**, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 05.04.2023, nga trupat e vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7 datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit sipas ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr. 1 datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: znj. Kleada Mersinllari **Relatore**, z. Enton Radovani **Kryesues** dhe znj. Edona Dushaj **Anëtare**.
5. Trupa e vlerësimit në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”, me Vendimin nr. 1 datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Alban Saliko Dautaj.
6. Relatorja e çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e trupës së vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.



7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore me shkresën nr *** prot. datë 20.04.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Relatorja e çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Në vijim të procesit të mbështetur në nenet 33/1, 42 dhe 46 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, relatorja e çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse deklaratimet e subjektit të vlerësimit, si më poshtë vijon:
 - a. me shkresën nr. *** prot, datë 19.04.2023, ka dërgua pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin shoqërues;
 - b. me shkresën nr. *** prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit deklaratën e vlerësimit të aftësive profesionale;
 - c. me shkresën nr *** prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, deklaratën e kontrollit të figurës.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka për objekt:
 - ✚ Vlerësimin e pasurisë;
 - ✚ Kontrollin e figurës;
 - ✚ Vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar;
 - b. Ligjin nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
 - c. Ligjin nr. 40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”;
 - d. Ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”;
 - e. Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;
 - f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”;
 - g. Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”;

h. Duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme, dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore që janë:

-  *Deklarata e Pasurisë;*
-  *Deklarata për Kontrollin e Figurës;*
-  *Formulari i Vlerësimit Profesional;*
-  *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet.*

- i. Raportet përmbledhëse të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- j. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar;
- k. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit;
- l. Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gadishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

13. Trupa e vlerësimit, në datën 05.02.2024, pas dëgjoi relatorin e çështjes, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Alban Dautaj, me Vendimin nr. 5 datë 05.02.2024, vendosi:

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Alban Dautaj;
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 -  *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 -  *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
- c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga trupa e vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcioneve Publike”, si dhe nenit 3, pika 12 dhe 14, e ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

15. Në datën 16.02.2024, trupa e vlerësimit njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 22.02.2024, në orën 10:30, Salla e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE.

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Alban Datuaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë. Në fund të seancës dëgjimore të dates 22.02.2023, subjekti i vlerësimi z. Alban Dautaj kërkoi konfirmimin në detyrë. Në datën 01.03.2024, trupa e vlerësimit shpalli vendimin.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Me subjektin e vlerësimit është komunikuar me anë të postës elektronike, duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave. Subjekti i vlerësimit z. Alban Dautaj, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

16. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
17. Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit z. Alban Dautaj ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 07.03.2023, brenda afateve ligjore. Formulari i Pasurisë ka nr. 7 index, viti 2023.
18. Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
19. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
20. Gjithashtu, trupa e vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- ✚ deklaraten e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- ✚ raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- ✚ provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar;
- ✚ dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruar si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

A/IVLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI

21. ILDKPKI¹, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publik”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetur, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Alban Dautaj, ku është konstatuar se:

- a) **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- b) **nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- c) **nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- d) **nuk është kryer deklarim i rremë;**
- e) **subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

A/2. PROCEDURA E VLERËSIMIT/HETIMIT E KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT

22. Bazuar në nenin 34 të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, trupa e vlerësimit hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI; (b) raportin/vlerësimin e kryer nga ILDKPKI; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga

¹ Raporti nr. ****, datë 22.09.2023, i ILDKPKI-së.

organet publike dhe private sipas nentit 34 të ligjit 12/2018; (ç) deklaratimet e subjektit të vlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit; (dh) deklaratimet në seancë degjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

23. Trupa e vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllimin evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo ndonjë konflikti të interesit.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

Pasuria nr. 1

- ❖ Apartament në përdorim, apartamenti nr. **, me nr. pasurie *****, ZK *****, vol. **, fq. ***, me sipërfaqe 119.31 m², i ndodhur në Njësine Bashkiake nr. **, rruga, "5 maji", Vila L", shk. **, ap.**, Tiranë, në pronësi të shoqërisë "S.S.X" sh.p.k., me Nipt *****, me seli në rrugën "5 maji", Tiranë, me administrator dhe ortak të vetëm babanë tim Saliko Asllan Dautaj. Apartamenti më është dhënë në përdorim në mirëbesim, pa qira dhe pa kontrate noteriale. Apartamenti është lënë si kolateral për personin juridik, Banka Raiffeisen. **Vlera 0 lekë. Pjesa takuese: 0%**

Bashëlidhur deklaratës:

- Certifikatë për Vërtetim Pronësie nr. ***** lëshuar në datë 12.05.2020, për pasurinë nr. *****, ZK *****, vol. **, fq. ***, me sip. 119.31 m², e ndodhur në Tirane, në pronësi të "S.S.X" sh.p.k, (dokumenti dorëzuar bashkëlidhur kontratës së huasë bankare nr. **** rep., nr. **** kol., datë 15.03.2021, lidhur ndërmjet Raiffeisen Bank sh. a, dhe Malvina e Alban Dautaj, për kredinë në vlerën 4.000.000 lekë.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit.

- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e ASHK** me shkresën nr. *** prot., 12.06.2023 konfirmon faktin se për subjektin e vlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk figurojnë të regjistruar pronësi në emër të tyre.

24. Me e-mailin e datës 14.07.2023, mbajtur me korespondencë pranë ILDKPKI-së dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit subjekti i vlerësimit sqaroi se:

- *Për mbajtjen në përdorim të këtij apartamenti do të paraqesë deklaratën noteriale të përdorimit të apartamentit si dhe kontratat e sipërmarrjes dhe shkëmbimit se si shoqëria "S.S.X" sh.p.k, ka përfutuar pronësinë mbi apartamentin e banimit të deklaruar nga ana e tij. Deklaroi se nuk ka*

*pasur asnjëhere pasuri të tjera të paluajtshme, prona me qira apo në përdorim. Para se të banonte në apartamentin aktual, ka banuar në shtëpinë e prindërve e cila ndodhet në adresën e deklaruar nga ana e tij: Njësia Bashkiake nr. 3, rruga "Sitki Çiço", pallati ***, Shk. **, Ap. **.*

24.1 Sipas inventarit **nr. Extra prot., datë 14.07.2023**, në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament banimi (në përdorim) subjekti ka dorëzuar:

- Deklarate Noteriale nr. **** rep., nr. **** kol., datë 12.07.2023, sipas së cilës deklaruesi Saliko Dautaj, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “S.S.X” sh.p.k, deklaroi kjo shoqëri është pronare e pasurisë së paluajtshme me nr. pasurie *****, ZK ****, vol. **, fq. ***, e llojit apartament me sipërfaqe totale 119.31 m², me adresë në rruga “5 maji”, Tiranë, sipas Certifikatës për Vërtetim Pronësie me nr. serie *****, lëshuar në datë 12.05.2020 nga ZVRPP, Drejtoria Tirana Veri, dhe se këtë apartament ja ka dhënë për banim pa kundër-shpërblim djalit të tij Alban Dautaj për të banuar se bashku me familjen e tij, për një kohëzgjatje të pacaktuar. Gjithashtu, deklaroi se për shkak të marrëdhënies së posaçme midis tyre, apartamenti është lënë në përdorim në kushtet e mirëbesimit pa ndonjë kontratë noteriale për këtë qëllim.
- Certificate për Vërtetim Pronësie nr. *****, lëshuar në datë 12.05.2020, për pasurine nr. *****, ZK ****, vol. **, fq. ***, me sip. 119.31 m², e ndodhur në rruga “5maj”, Tiranë, në pronësi të “S.S.X” sh.p.k.
- Kontrate bashkëpunimi dhe sipërmarrje në ndërtim nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.09.2016, lidhur ndërmjet shoqërisë “S.S.X.” sh.p.k. dhe shoqërisë “SIFLAD” sh.p.k, me objekt ndërtimin dhe zhvillimin e një godinë shumëkateshe me destinacion banimi dhe tregtimi me 7-8-9 kate mbi tokë dhe 2 kate garazhe nën tokë nga ana e shoqërisë “SIFLAD” sh.p.k me mjetet e veta financiare, mbi pronën në pronësi të shoqërisë “S.S.X” sh.p.k, kundrejt 34% të sipërfaqes ndërtimore, e cila do t'i kalojë shoqërisë “S.S.X” sh.p.k. pa kundërshpërblim.
- Kontratë shkëmbimi pasuri të paluajtshme nr. **** rep., nr. *** kol., datë 05.05.2020, lidhur ndërmjet shoqërisë “S.S.X.” sh.p.k. dhe shoqërisë “SIFLAD” sh.p.k. me objekt kalimin e ndërsjelle të pronësive të paluajtshme, sendeve ose të drejtave të tjera nga njëri kontraktues tek tjetri, (në listën e pasurive të shkëmbyera rezultoi apartament me sip. 119.31 m²).
- Formular aplikimi RSF, datë 16.09.2019, i Raiffeisen Bank me kredimarrës Malvina Dautaj për marrjen e kredisë në vlerën 224.963 lekë, për financimin e produkteve “Frigorifer, lavatriçe, pianure, furrë”.
- Fature tatimore shitje nr. ****, datë 16.09.2019. lëshuar nga Neptun sh.p.k. për blerjen e produkteve syprinë, në vlerën 30.591 lekë, furrë në vlerën 50.391 lekë, lavatriçe në vlerën 67.491 lekë dhe frigorifer në vlerën 76.490 lekë. Vlera e përgjithshme 224.963 lekë.

24.2 **Trupa e vlerësimit** bazuar në deklarinimin e subjektit si dhe referuar dokumentacionit të paraqitur si dhe në korrespondencën e administruar nga institucionet ligjzbatuese, **konstaton se pasuria** me nr. *****, Zk ****, vol. **, fq. ***, me sip. *** m², e ndodhur në Tiranë, në përdorim të subjektit deklarues është në zotërim 100% të shoqërisë “S.S.X.” sh.p.k., dhe i është lënë subjektit në përdorim

në kushtet e mirëbesimit për shkak të marrëdhënieve familjare (prind-femijë) me ortakun e vetëm të shoqërisë.

24.3 Subjekti ka dhënë shpiegime lidhur me shpenzimet për apartamentin në përdorim të cilat rezultojnë me përafërsi në verën 1.525.000 lekë, shpenzimet janë realizuar më burim nga kredia hipotekore e marrë së bashku me bashkëshorten e tij.

✚ Në lidhje me shpenzimet për arredimin e këtij apartamenti në përdorim subjekti i vlerësimit ka deklaruar vlerën e përafërt prej 1.525.000 lekë, ku si burim për mbulimin e këtyre shpenzimeve kanë rezultuar kredi të marra nga subjekti i vlerësimit dhe bashkëshortja e tij për periudhat 2019-2021. Trupa e vlerësimit ka administruar dokumentacionin bashkëlidhur deklarimit të pasurisë dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga banka Raiffeisen nga ku ka rezultuar se:

1. Me kredinë e datës 16.09.2019 *me reference ****** me palë znj. Malvina Dautaj dhe Raiffeisen Bank vlera e së cilës është 224.963 lekë me objekt blerjen e paisjeve elektroshtëpiake si frogorifer, lavatrice, pianure, furrë si dhe është bashkëlidhur fatura tatimore e blerjes së këtyre pajisjeve që mban vlerën 224.963 lekë.
2. Subjekti nëpërmjet e-mail-it te datës 14.07.2023 gjithashtu ka sqaruar se: *“mobilimi i shtëpisë është kryer në periudhën fund 2018 dhe fillim 2019, periodikisht gjatë kësaj periudhe. Mobilimi është kryer me mobilie të cilat janë porositur në mobilieri dhe individë për të cilat nuk disponon faturë, por mesa kujton kanë qenë në vlerën rreth 800.000 lekë (ku përfshihen kuzhinë gatimi, tavoline, karrige, kolltuqe, soxhorno, biblioteke, dollape, krevate). Në shtëpi janë kryer dhe punime ekstra si p.sh. tavan i varur, patinim, parket, hidrosanitare, të cilat me sa kujton kanë kushtuar rreth 400.000 lekë, por që nuk disponon fatura.*

24.4 Në lidhje me pagesat që mbajë vlerat më përafërsi 800.000 lekë dhe 400.000 lekë trupa e vlerësimit ka konfirmuar nëpërmjet llogarive bankare të subjektit dhe të bashkëshortes së tij:

- a. disbursimin e kredive të marra përgjatë kësaj periudhe;
- b. momentet e tërheqjes së shumave nga llogaritë bankare;
- c. shumat e tërhequra përgjatë periudhës 2018-2019,

nga ku rezulton përputhshmëri e përafërt me shumat e pretenduara për mobilimin e apartamentit të banimit nga subjekti i vlerësimit.

24.5 Me kredinë nr.*** rep., nr. *** kol., datë 15.03.2021, lidhur ndërmjet Raiffeisen Bank sha., dhe Malvina e Alban Dautaj, për kredinë në vlerën 4.000.000 lekë rezulton lëvizja e datës 06.04.2021 konvertimin e shumës 1.230.000 lekë në 10.000 euro, ndërmjet llogarive të saj, në datën 14.04.2021 *transferten në favor të Frigo Beair Technology sh.p.k. shumën 7.000 euro* e konvertuar në vlerën 803.000 lekë ka shërbyer për blerjen e sistemit të kondicionimit.

24.6 Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjien e Raiffeisen Bank. Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me shpenzimet për sistem kondicionimi, në vlerën 7.000 euro, e konvertuar në vlerën 803.000 lekë, të cilat rezultojnë për apartamentin në përdorim.

24.7 Me email-in e datës 14.09.2023, subjekti sqaroi se blerja e sistemit të kondicionimit (sistemit çiller) është kryer për banesën që ka deklaruar në përdorim. Lidhur me tërheqjen cash në datën 07.04.2021 të shumës 300.000 lekë, subjekti sqaroi se kjo shumë është gjendja cash që mban në banesë e deklaruar nga ana e tij, e cila mbahet për raste urgjencash, si probleme shëndetësore apo përdorim familjar.

24.8 Trupa e vlerësimit konstaton se shpenzimet e kryera nga subjekti i vlerësimit e kanë burimin nga kredit e marra nga subjekti dhe bashkëshortja e tij.

24.9 Të gjitha kreditë e marra në mënyrë vazhduese në harkun kohor 2019-2021 për përdorim personal dhe për shpenzime arredimi janë shlyer nëpërmjet marrjes së kredisë “konsumatore me hipoteke” e cila pasqyrohet në kontraten e huasë bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.03.2021, lidhur ndërmjet Raiffeisen Bank sha., dhe Malvina e Alban Dautaj, për kredinë në vlerën 4.000.000 lekë.

Konkluzion:

25 Trupa e vlerësimit në lidhje me pasurinë “Apartament banimi në përdorim” të subjektit të vlerësimit konstaton se:

- ✓ Konfirmohet përputhshmëri e deklarimit të subjektit të vlerësimit me rrethanat e faktit dhe dokumentacionin e administruar.
- ✓ Konfirmohet deklarimi i shpenzimeve të subjektit me verifikimet e kryera nëpërmjet llogarive bankare të subjektit dhe bashkëshortes së tij në lidhje me shumën e shpenzimeve për mobilim banese në përdorim.
- ✓ Burimi i krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për mobilimin e apartamentit është i ligjshëm i krijuar **nga kredit e marra nga subjekti dhe bashkëshortja e tij.**

Pasuria nr. 2

❖ Gjendje cash. Vlera: 300.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga, kredia dhe kursime familjare.

✚ Subjekti i vlerësimit në e-mailin e datës 15.09.2023 i pyetur në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie ka dhënë shpjegime se shuma prej 300.000 lekë ka si burim kredinë e disbursuar në 02.04.2021, në vlerën 4.000.000 lekë (*e cila do trajtohet në rubrikën e detyrimeve financiare*)

26 Trupa e vlerësimit referuar deklarimit të subjektit ka kryer verifikimet në të dhënat bankare të subjektit të vlerësimit dhe bashkëshortes së tij nga ku ka rezultuar se në datën 07.04.2021, nga ana e bashkëshortes znj. Malvina Dautaj është kryer tërheqja e shumës prej 300.000 lekësh. Kjo tërheqje është realizuar pas disbursimit të kredisë hipotekore me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.03.2021.

Konkluzion:

26.1 Trupa e vlerësimit konfirmon se deklarimi i subjektit është në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe burimi i krijimit të kësaj pasurie është i ligjshëm.

Pasuria nr. 3

❖ Llogari individuale page pranë Raiffeisen Bank me nr. *****. Gjendja e balancës në datën 14.02.2023, vlera: 0 leke. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie datë 04.04.2018, nga Raiffeisen Bank, për logarinë nr. *****, të Alban Dautaj, për periudhën 08.07.2005 - 27.02.2018. Gjendja në llogari në 27.02.2018 në vlerën 20.149 lekë.
- Nxjerrje llogarie datë 14.02.2023, nga Raiffeisen Bank, për llogarinë nr. ***** të Alban Dautaj, për periudhën 05.04.2018 - 25.01.2023. Gjendja në llogari në 25.01.2023, në vlerën - 3.859 lekë.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Alban Dautaj ka llogari page me gjendje në datën 07.03.2023 me vlerën 50.662 lekë. Raiffeisen Bank konfirmon llogarinë e pagës së subjektit. Gjendja rezulton 50.662 lekë në datë 07.03.2023.

27 Trupa e vlerësimit gjatë verifikimit të llogarive bankare të subjektit të vlerësimit ka venë re që në periudha të ndryshme gjatë viteve 2005-2010, në llogarine e pagës janë kredituar në mënyrë periodike vlera të ndryshme që variojnë nga 30.000-60.000 lekë të cilat në përshkrimin e tyre mbajnë emërtimin “derdhje Alban Dautaj”.

27.1 Në e-mailin e datës 31.10.2023, relatori i çështjes ka kërkuar nga subjekti i vlerësimit **shpjegime në lidhje me këto derdhje dhe burimin e krijimit**.

27.2 Subjekti i vlerësimit me shkresën nr. *** prot., datë 10.11.2023, ka dhënë shpjegime në lidhje me kërkimin si më poshtë vijon:

- *“Këto derdhje janë kryer nga ana ime dhe shumat janë kursimet e mia ndërvite. Duke qenë se periudhat e referuara nga ana Juaj janë të largëta me sa më kujtohet disa nga shumat që nuk lidhen me marrjen e pagës janë kurisme të cilat mi ka dhënë familja ime ndër vite për shpenzime (përpara se të futesha në polici dhe deri sa u martova dhe u ndava nga trangu familjar shpenzimet për jetesën janë përballuar nga prindërit e mi.) Disa prej derdhjeve në cash janë para të tërhequra nga të ardhurat nga paga, të cilat nuk i kam harxhuar dhe i kam rikthyer në llogari”.*

27.3 Gjithashtu, nga verifikimi i llogarisë së pagës së subjektit të vlerësimit është vënë re se për periudhat 2019-2023, janë realizuar kalime të shpeshta të shumave që variojnë nga 10.000-40.000 lekë. Gjendur në këto kushte relatori i çështjes me e-mailin e datës 31.10.2023 ka kërkuar shpjegim nga subjekti i vlerësimit mbi identitetin e personit që ka kryer këto transfera në llogarinë e tij të pagës.

27.4 Subjekti i vlerësimit më shkresën nr. *** prot., datë 10.11.2023, ka dhënë shpjegimet si më poshtë vijon:

- *“Personi i cili mi ka dërguar këto shuma është bashkëshortja ime Malvina Dautaj dhe këto shuma kanë kaluar nga të ardhurat e saj nga paga/bonuse, për shpenzime të përditshme familjare. Periudhat e pagesave në llogarinë time përkojnë me datat e marrjes së pagës nga ana e bashkëshortes.”*

Bashkëlidhur subjekti i vlerësimit ka pasqyruar:

- Njoftim debitimet bankare që u referohen pagave të znj. Malvina Dautaj nga Raiffeisen Bank.

27.5 **Trupa e vlerësimit**, referuar kthim-përgjigjeve dhe dokumentacioneve të vëna në dispozicion nga subjekti i vlerësimit konstaton përputhshmëri të rrethanave të faktit me kthim-përgjigjet dhe dokumentacionet e pasqyruara nga subjekti i vlerësimit.

Konkluzion:

27.6 **Trupa e vlerësimit konfirmon se deklarinin i subjektit është në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, burimi i krijimit të kësaj pasurie është i ligjshëm, si dhe verifikohet fakti që të ardhurat ndër vite në këto llogari kanë qenë nga paga.**

Pasuria nr. 4

❖ Llogari individuale overdrafti pranë Raiffeisen Bank, me nr. *****. Gjendja e balances në datën 14.02.2023. **Vlera:** 250.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. **Burimi i krijimit:** Overdraft në shumën 250.000 lekë.

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Alban Dautaj ka llogari overdrafti, me gjendje në datën 07.03.2023 në vlerën -250.000 lekë.

28 **Trupa e vlerësimit konfirmon**, përputhshmerinë e deklarinimit të subjektit të vlerësimit me dokumentacionin e administruar nga bankat e nivelit të dytë.

Konkluzion:

28.1 **Trupa e vlerësimit konfirmon se deklarimi i subjektit është në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe burimi i krijimit të kësaj pasurie është i ligjshëm.**

Pasuria nr. 5

❖ Llogari rrjedhese individuale në euro pranë Raiffeisen Bank me nr. *****. Gjendja e balancës në datën 14.02.2023. **Vlera:** 0 euro. Pjesa takuese: 100%. **Burimi i krijimit:** Kursime personale, si dhe rimbursime shpenzimesh kryesisht për shërbimet e punës.

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. **** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Alban Dautaj ka llogari rrjedhëse në euro me gjendje në 07.03.2023 është 0 euro. Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Raiffeisen Bank.

29 Trupa e vlerësimit konstaton se, subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit të pasurisë, ka pasqyruar në përputhje me nenin 32 dhe 33 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre.

Konkluzion:

29.1 **Trupa e vlerësimit konfirmon se deklarimi i subjektit është në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe burimi i krijimit të kësaj pasurie është i ligjshëm.**

A/3 DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

❖ Subjekti i vlerësimit në rubrikën e të ardhurave ka deklaruar në rend kronologjik të ardhurat e përfituara nga momenti i fillimit të punës në strukturën e Policisë së Shtetit:

- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht Specialist i Policisë Kufitare në Komisaratin e Policisë Rinas, për vitin 2005 (paga, shpërblime, orë shtesë, veshje). **Shuma 168.097 lekë.**
- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht Specialist i Policisë Kufitare në Komisaratin e Policisë Rinas, për vitin 2006 (paga, shpërblime, orë shtesë, veshje). **Shuma 558.479 lekë.**
- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht Komandanti i Postës së Policisë Bovillë dhe Specialist i Komisarimit të Policisë nr.1, Tiranë për vitin 2007 (paga, shpërblime, orë shtesë, veshje). **Shuma 552.835 lekë.**
- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht Specialist për Hetimin e Narkotikëve në DPQ Tiranë për vitin 2008 (paga, shpërblime, orë shtesë, veshje). **Shuma 658.653 lekë.**
- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht Specialist në Komisaratin e Policisë Kufitare Rinas dhe Specialist për Hetimin në Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë për vitin 2009 (paga, shpërblime, orë shtesë, veshje). **Shuma 572.438 lekë.**
- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht Specialist i Seksionit të Hetimit dhe Analizes së Riskut në Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, Tiranë për vitin 2010 (paga, shpërblime, orë shtesë, veshje). **Shuma 602.972 lekë.**

- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht Shefi i Seksionit të Hetimit dhe Analizës së Riskut në Drejtoria e Rajonale e Kufirit dhe Migracionit, Tiranë për vitin 2011 (paga, shpërblime, orë shtesë, veshje). **Shuma 623.319 lekë.**
- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht Shefi i Seksionit të Rendit dhe Sigurisë në Komisariatin e Policisë Rinas për vitin 2012 (paga, shpërblime, orë shtesë, veshje). **Shuma 639.096 lekë.**
- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht Shefi i Seksionit të Rendit dhe Sigurisë në Komisariatin e Policisë Rinas për vitin 2013 (paga, shpërblime, orë shtesë, veshje). **Shuma 611.458 lekë.**
- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht si Shefi i Seksionit të Rendit dhe Sigurisë në Komisariatin e Policisë Rinas dhe Shef Sektori për hetimin e Narkotikëve dhe Trafikeve në Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë për vitin 2014 (paga, shpërblime, orë shtesë, veshje). **Shuma 779.333 lekë.**
- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht si Shef Sektori për hetimin e Narkotikëve dhe Trafikeve në Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë, Specialist në Akademinë e Sigurisë, Specialist në 2QK Interpol Tirana dhe Specialist Sektori për Narkotiket në Drejtorinë e Narkotikëve dhe Trafikeve në DPPSH për vitin 2015 (paga, shpërblime, orë shtesë, veshje). **Shuma 861.656 lekë.**
- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht si Specialist Drejtimi në Sektorin e Hetimit, Drejtoria e Antiterrorit dhe Specialist Sektori për Narkotikët në Drejtorinë e Narkotikëve dhe Trafikeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2016 (paga, shpërblime, orë shtesë, veshje). **Shuma 875.952 lekë.**
- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht si Specialist Drejtimi në Sektorin e Hetimit, Drejtoria e Antiterrorit për vitin 2017 (paga, shpërblime, orë shtesë, veshje). **Shuma 941.972 lekë.**
- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht si Specialist Drejtimin e Sektorin e Hetimit, Drejtoria e Antiterrorit për vitin 2018 (paga, shpërblime, orë shtesë veshje). **Shuma 826.060 lekë.**
- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht si Specialist Drejtimi ne Sektorin e Hetimit, Drejtoria e Antiterrorit për vitin 2019 (paga, shpërblime, ore shtesë, veshje). **Shuma 1.156.594 lekë.**
- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht si Specialist Drejtimi në Sektorin e Hetimit, Drejtoria e Antiterrorit për vitin 2020 (paga, shpërblime, ore shtesë, veshje). **Shuma 1.154.494 lekë.**
- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht si Specialist Drejtimi në Sektorin e Hetimit, Drejtoria e Antiterrorit për vitin 2021 (paga, shpërblime, orë shtesë, veshje). **Shuma 1.191.321 lekë.**
- Shpërblim OFL (Operacioni Forca e Ligjit) bazuar në aktin normativ nr. 1 datë 31.1.2020 "Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimin të organizuar, krimeve të rënda dhe kontrollit të rendit dhe sigurisë publike, paguar si pagë në vitin 2021. **Shuma 584.974 lekë.**
- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht si Drejtor i Drejtorisë së Antiterrorit për vitin 2022 (paga, shpërblime, orë shtese, veshje). **Shuma 1.263.346 lekë.**

- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit dhe konkretisht si Drejtor i Drejtorisë së Antiterrorit për vitin 2023 (paga, shpërblime, ore shtesë, veshje). **Shuma 169.384 lekë.**
- Të ardhura nga shitja e automjetit tip Mercedes Benz viti i prodhimit 1996, shitur në datë 23.5.2015 shoqërisë “S.S.X” sh.p.k, me kontratën me nr. *** rep., nr. *** kol. **Shuma 300.000 lekë.**

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie datë 04.04.2018, nga Raiffeisen Bank, për llogarinë nr. *****, të Alban Dautaj, për periudhën 08.07.2005 - 27.02.2018, ku rezulton se ka përfituar të ardhura në shumën 9.033.398 lekë. Gjendja në llogari në 27.02.2018 në vlerën 20.149 lekë.
- Nxjerrje llogarie, datë 14.2.2023, nga Raiffeisen Bank, për llogarinë nr. *****, të Alban Dautaj, për periudhën 05.04.2018 - 25.01.2023, ku rezulton se ka përfituar të ardhura në shumën 6.572.974 lekë. Gjendja në llogari në 25.01.2023 në vlerën -3.859 lekë.
- Kontratë shitje automjeti nr. **** rep., nr. *** kol., datë 23.05.2015 me shitës Alban Dautaj dhe blerës shoqëria “S.S.X” sh.p.k., për automjetin Mercedes Benz, me targë TR6066M, shitur në vlerën 300.000 lekë.

Hetimi i zhvilluar mbi verifikimin e të ardhurave të deklaruara:

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon nga nxjerrjen e llogarisë së Alban Dautaj ka përfituar të ardhura nga paga dhe shpërblime për periudhën shtator 2005 -mars 2023, në shumën 14.594.741 lekë, të ardhura nga dietat 588.846 lekë, të ardhura për veshje në shumën 250.500 lekë, të ardhura nga honoraret në shumën 207.195 lekë, si dhe të ardhura për punë jashtë orarit në shumën 60.969 lekë. Në total shuma 15.702.251 lekë.
- ✚ Gjithashtu, konfirmon nga nxjerrjet e llogarisë së Alban Dautaj ka përfituar në datën 30.06.2015, kreditimin e shumës 300.000 lekë nga “S.S.X” sh.p.k., me përshkrim “pagese për blerjen e autovetures tip Benz, targë *****”.
- ✚ **Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresën nr. *** prot., datë 10.05.2023, konfirmon se z.Alban Dautaj ka realizuar të ardhura nga punësimi për periudhën janar 2012 - mars 2023, nga organet në varësi të Policisë së Shtetit.

Konkluzion:

- 30 **Trupa e vlerësimit nga verifikimi i kryer ka konstatuar përputhshmëri mbi deklarimin e të ardhurave të pasqyruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e pasurisë dhe të dhënat e mbledhura nga institucionet ligjbatuese dhe bankat e nivelit të dytë.**
- ❖ **Hetimi i zhvilluar nga trupa e vlerësimit në lidhje me shumën prej 300.000 lekë përfituar nga kontrata e shitjes së automjetit.**

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor**, me shkresën nr. *** prot., datë 10.05.2023, konfirmon se Alban Dautaj ka pasur në pronësi automjetin me targë *****, me nr. shasje ******, blerë në vlerën 1.000 euro, me kontratë shitblerje datë 10.11.2006, hartuar ne gjuhën gjermane, vërtetuar përkthimi me Vërtetim nr. ***** rep., datë 23.11.2006, të noteres Sh. GJ, dhe shitur me kontratë shitje automjeti nr. **** rep., nr. **** kol., datë 23.05.2015, me shitës Alban Dautaj dhe blerës shoqëria “S.S.X” sh.p.k., në vlerën 300.000 lekë.

31 **Me email-in e datës 14.07.2023**, subjekti sqaroi lidhur me automjetin e shitur, se:

- *“Vlera 1.000 euro konvertuar me kursin e kohës, sipas faturës së doganës 1 euro/123.45 lekë pra 123.450 lekë, është vetëm vlera e blerjes fizike të automjetit, pa vlerën e pagesës së doganës, e cila me çmim reference në vitin 2006 është paguar nga ana e tij në vlerën 140.534 lekë. Subjekti sqaroi se, janë shtuar gjithashtu pagesat e targave, taksave, kolaudimi dhe siguracioni e me vonë është investuar nga ai në automjet duke vendosur edhe një impiant gazi, në vlerën 25.500 lekë, që do të thotë se vlera e automjetit është më e lartë se vlera e shitjes 300.000 lekë dhe për këtë arsye nga shitja e automjetit nuk ka fituar asnjë para”*

✚ Subjekti bashkëlidhur kthim-përgjigjes sipas inventarit nr. Extra prot., datë 14.07.2023, ka dorëzuar:

- Kontrate shitblerje në gjuhën gjermane, për blerjen e automjetit me nr. shasje ******, nga Alban Dautaj, në vlerën 1.000 euro.
- Formular doganor nr. R ******, datë 22.11.2006, për importim individual automjeti, për pagesën nga Alban Dautaj, të vlerës 140.534 lekë.
- Fature tatimore shitje nr. **, datë 24.04.2015, e shitësit Julian Pushaj, me NIP-T K*****E, për blerjen nga Alban Dautaj, të një impianti gazi në vlerën 25.500 lekë.
- Kontrate shitje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.05.2015, me shitës Alban Dautaj dhe blerës shoqëria “S.S.X” shp.k, për shitjen e automjetit Mercedes Benz me nr. shasje ******, në vlerën 300.000 lekë.

31.1 **Trupa e vlerësimit** mbi shitjen e automjetit Mercedes Benz me palë shitëse Alban Dautaj dhe palë blerëse shoqërinë “S.S.X” sh.p.k, me targë ***** krahas kontratës së blerjes dhe shitjes ka kërkuar nga subjekti i vlerësimit shpjegime mbi faktin e shitjes së makina në vlerë 300.000 lekë nëse janë paguar detyrimet tatimore duke qënë se vlera e blerjes së saj është 1.000 euro.

31.2 Subjekti i vlerësimit nëpërmjet e-mailit të datës 14.07.2023, në lidhje me automjetin e shitur dhe pagesën e detyrimit tatimor shprehet si më poshtë:

- *vlera 1.000 Euro konvertuar me kursimin e kohës sipas faturës së doganës 1 Euro/123.34 lekë, është vetëm vlera e blerjes fizike të automjetit pa vlerën e pagesës së doganës e cila me çmimin referues në vitin 2006 është paguar nga ana ime në vlerën 140.534 lekë. Janë shtuar gjithashtu pagesat e targave, tatimeve, kolaudimi dhe siguracionit. Më vonë është investuar nga ana ime në automjet duke vendosur dhe një impiant gazi në vlerën 25.500 lekë që do të thotë se vlera e automjetit është më e lartë se vlera e shitjes 300.000 lekë dhe unë nga shitja e automjetit nuk*

kam fituar asnjë para”. Subjekti ka bashkëlidhur fotokopjen e deklaratës doganore dhe faturën e impiantit të gazit.

31.3 Trupa e vlerësimit referuar legjislacionit në fuqi (në kohën e shitjes së pasurisë automjet ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”), konstaton faktin se shpenzimet e kryera nga subjekti i vlerësimit për automjetin në lidhje me pagimin e taksave dhe vendosjen e impiantit të gazit **nuk justifikojnë faktit e mospagimit të tatimit mbi fitimin** në diferencën e çmimit të shitjes dhe atij të blerjes së automjetit.

Konkluzion:

31.4 Trupa e vlerësimit nga verifikimi i kryer ka konstatuar përputhshmëri mbi dekarimin e të ardhurave të pasqyruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e pasurisë dhe të dhënat e mbledhura nga institucionet ligjzbatuese dhe bankat.

31.5 Mospagimi i tatimit mbi fitimin në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe legjislacionit tatimor, në rastin e hetimit pasuror nuk do të konsiderohet si e ardhur e ligjshme.

A/3 DETYRIMET FINANCIARE

Detyrimi nr.1

❖ Bashkëkredimarrës i një kredie bankare me hipoteke pranë Raiffeisen Bank sh.a., në vlerën 4.000.000 lekë, me kohëzgjatje nga 02.04.2021 deri në 02.04.2041, me këst 16.700 lekë. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer: 3.634.061 lekë.

*Shënim: Kredia është marrë për shlyerjen e një kredie tjetër dhe për arredim shtëpie banimi. Kontrate Kredie Bankare nr. **** rep., nr. *** kol., datë 15.03.2021.*

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë huaje bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.03.2021, lidhur ndërmjet Raiffeisen Bank sh.a., dhe Malvina e Alban Dautaj, për kredinë në vlerën 4.000.000 lekë, me qëllim kredi "konsumatore me hipoteke", për mbylljen e 3 kredive që kredimarrësit kanë pranë Raiffeisen Bank sh.a., konkretisht, kredia me nr. *****, sipas kontratës së datës 21.10.2019, kredia me nr. *****, sipas kontratës së datës 08.01.2021, dhe kredia me nr. *****, sipas kontratës së datës 16.09.2019. Pjesa e mbetur autorizohet në llogari të kredimarrësit dhe do të përdoret për qëllimin e sipërpërmendura. Për garantimin e kredisë, hipotekuesi shoqëria “S.S.X” sh.p.k., krijon hipotekë mbi pasurinë apartament, me nr. pasurie ***** ZK ****, vol. **, fq.***, me sip. 119.31 m², e ndodhur në Tiranë, regjistruar pranë ASHK Tirana Veri bashkëlidhur kontratës, (Certifikatë për Vërtetim Pronësie nr. ****, lëshuar në datë 12.05.2020, për pasurinë nr. ****, ZK ****, vol. **, fq. **, me sip.119.31 m², e ndodhur në Tiranë, në pronësi të “S.S.X” sh.p.k.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit.

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se në emër të Malvina Dautaj rezulton:

- a. Kredi e disbursuar në 02.04.2021, me reference *****, në vlerën 4.000.000 lekë, me gjendje detyrimi në 07.03.2023 në vlerën 3.617.467 lekë. Nga nxjerrjet e llogarise së Malvina Dautaj;
- b. Në datën 02.04.2021, rezulton transaksioni në vlerën 144.183 lekë me përshkrim “pagese *principali kredie*” me reference ***** në datën 02.04.2021, rezulton transaksioni në vlerën 106.232 lekë, me përshkrim "pagese *principali kredie*" me reference *****.
- c. Në datën 02.04.2021 rezulton transaksioni në vlerën 1.728.988 lekë, me përshkrim “pagese *principali kredie*” me reference *****.


32. Trupa e vlerësimit konstaton se nga Kontratë Kredie Bankare nr. ***** rep., nr. *** kol., datë 15.03.2021 me vlerë 4.000.000 lekë, është përdorur vlera 2.394.963 lekë për shlyerjen e kredive:

- a. Kredi me nr. ***** datë 21.10.2019 vlera 2.000.000 lekë;
- b. Kredi me nr. ***** datë 08.01.2021 vlera 150.000 lekë;
- c. Kredi me nr. ***** datë 16.09.2019 vlera 244963 lekë.

32.1 Vlera e mbetur prej 1.605.037 lekë e mbetur nga verifikimi ka rezultuar e kredituar në llogari të znj. Malvina Dautaj dhe është përdorur për nevoja personale të familjes dhe pagesa sikurse deklarohet subjekti i vlerësimit ku konfirmohet konvertimi i shumës 1.230.000 lekë në 10.000 euro.

Gjithashtu rezultojnë:

1. Kredi e disbursuar në 19.04.2017 me referencë *****, në vlerën 2.000.000 lekë, investuar shuma 1.500.000 lekë në RFZ Invest.
2. Kredi e disbursuar në 11.12.2018, me referencë *****, në vlerën 2.000.000 lekë, përdorur shuma 1.596.951 lekë, për shlyerjen e kredisë me referencë *****.
3. Kredi e disbursuar në 17.9.2019, me referencë *****, në vlerën 224.963 lekë.
4. Kredie disbursuar në 21.10.2019, me referencë *****, në vlerën 2.000.000 lekë, përdorur shuma 1.781.113 lekë për shlyerjen e kredisë, me referencë *****.
5. Kredi e disbursuar në 08.01.2021, me referencë *****, në vlerën 150.000 lekë.

 **Raiffeisen Bank**, konfirmon nga nxjerrjet e llogarisë së Malvina Dautaj se ka kryer në datën 06.04.2021 transfertën në favor të Alban Dautaj, shumën 300.000 lekë, me përshkrim "pagese për shpenzime", në datën 06.04.2021 konvertimin e shumës 1.230.000 lekë në 10.000 euro, ndërmjet llogarive të saj, në datën 14.04.2021 transfertën në favor të Frigo Beair Technology sh.p.k, shumën 7.000 euro dhe në datën 07.04.2021 tërheqjen nga llogaria të shumës 300.000 lekë. **Trajtuar më lart.**

Konkluzion:

32.2 Trupa e vlerësimit nisur nga deklarimi i subjektit dhe personit të lidhur, verifikimi i fakteve dhe dokumentacionit të administruar konfirmon përputhshmërinë e deklarimit të subjektit dhe personit të lidhur me rezultatet e hetimit.

Detyrimi nr. 2

- ❖ **Kartë krediti pranë Raiffeisen Bank sha.**, në vlerën 2.000 euro. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer: 1.970 euro. *Shënim: Shpenzime personale, si dhe familjare.*

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit.

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. **** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Alban Dautaj ka llogari në euro, me gjendje në 07.03.2023, vlera - 1.858 euro.

Konkluzion:

33. Trupa e vlerësimit konstaton përputhshmëri midis deklarimit të subjektit të vlerësimit dhe përgjigje së Raiffeisen Bank.

Detyrimi nr. 3

- ❖ **Overdraft pranë Raiffeisen Bank sha.**, në vlerën 250.000 lekë. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer. **Nuk kam detyrime të pashlyera pasi shuma e overdraftit nuk është e përdorur në momentin e deklarimit.**

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit.

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Alban Dautaj ka llogari overdrafti, me gjendje në datën. 07.03.2023, shumën 250.000 lekë.

Konkluzion:

34. Trupa e vlerësimit konstaton përputhshmëri midis deklarimit të subjektit të vlerësimit dhe përgjigje së Raiffeisen Bank, konfirmohet se subjekti i vlerësimit ka çelur overdraft me vlerë limit 250.000 lekë, i cili rezulton i papërdorur.

A/4 Shpenzimet e deklarueshme

Të viti të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit të vlerësimit ose personave të lidhur me të. Periudha 01.01.2022-31.12.2022.

- Shpenzim për pagesën e energjisë elektrike, kundrejt kompanisë FSHU sh.a, për vitin 2022. **Shuma 116.670 lekë.**
- Shpenzim për pagesën kundrejt kompanisë UKT sh.a, për vitin 2022. Shuma 26.140 lekë.
- Shpenzim për pagesën e telefonit celular 06*****, kundrejt kompanisë Vodafone Albania sh.a., për vitin 2022, që rimburohet nga qendra e punës. **Shuma 7.200 lekë.**
- Shpenzim për pagesën e telefonit celular 06*****, kundrejt kompanisë OneAlbania sh.a., për periudhën gusht - dhjetor 2022. **Shuma 2.500 lekë.**
- Shpenzime për pagesën e telefonit celular 06*****, përdorur nga bashkëshortja për vitin 2022, kundrejt kompanisë Telekom Albania sh.a. **Shuma 12.300 lekë.**

- Shpenzim për pagesën e internetit Homenet, kundrejt kompanisë One Albania sh.a. për vitin 2022. **Shuma 10.800 lekë.**

Bashkëlidhur deklaratës:

- Libreza e OSHEE me nr. kontrate AL*****, me adresë rruga, “5 maji”, në emër të “S.S.X” sh.p.k, për pagesën e detyrimit mujor në shumën e përgjithshme 86.161 lekë për vitin 2022.
- Libreze e Ujësjes Kanalizime Tiranë, me nr. kontratë *****, në emër të “S.S.X” sh.p.k., për pagesën e detyrimit mujor në shumën e përgjithshme 21.667 lekë, për vitin 2022.
- ✚ **FSHU**, me shkresën nr. **** prot., datë 24.05.2023, konfirmon se Alban Dautaj dhe personat e lidhur me të, nuk rezultojnë të jenë abonentë me kontratë të furnizimit me energji elektrike.
- ✚ **15 Shoqërite Raionale të Ujësjes-Kanalizime**, me shkresat nr. **** prot, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga Alban Dautaj dhe personat e lidhur me të.
- ✚ **Vodafone Albania sh.a**, me shkresën nr. ***, datë 12.06.2023, konfirmon se shtetasi Alban Dautaj është i pajisur me numër telefonie celulare në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, për të cilin është shpenzuar **vlera 11.439 lekë**. Gjithashtu, konfirmon se shtetases Malvina Dautaj, i korrespondojnë numrat e telefonisë celulare 06***** dhe 06*****, për të cilat për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën 1.900 lekë.
- ✚ **One Albania sh.a**, me shkresën nr. **** prot., datë 21.07.2023, konfirmon se shtetasit Alban Dautaj i korrespondojnë numrat e telefonisë celulare 355***** dhe 355*****, për të cilët është shpenzuar vlera 8.842 lekë. Gjithashtu konfirmon se shtetases Malvina Dautaj, i korrespondon numri i telefonisë celulare 355***** për të cilin për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën 21.499 lekë.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit.

36. **Me e-mailin e datës 14.07.2023**, subjekti sqaroi se në dokumentacion e paraqitur pagesat janë deri në muajin tetor 2022, me pas pagesat janë vijuar të paguhen me bankë, sipas mandat pagesave bashkangjitur për OSHE dhe UKT. Subjekti sqaroi se do të depozitohet bashkëlidhur edhe deklaratën noteriale që detyrimet e OSHE dhe UKT paguhet nga subjekti. Lidhur me mospërputhjen e vlerave të deklaruara dhe konfirmimin nga Vodafone, subjekti sqaroi se duke qenë se pagesat i mbahen automatikisht nga llogaria bankare, ka ndodhur ndonjë gabim në përlllogaritje, duke tarifuar roaming, të cilat janë harruar nga ana e tij. Lidhur me shpenzimet e deklaruara për telefon dhe internet para One Albania, subjekti sqaroi se do të depozitohet konfirmimin e One Albania Sh.a, marrë në mënyrë elektronike me e-mail.
- **Sipas inventarit nr. extra** prot datë 14.07.2023, subjekti ka dorëzuar:
- Njoftim debitimi datë 14.12.2022 i Raiffeisen Bank, për pagesat e kryera nga Malvina Dutaj në favor të UKT Sh.a, për pagimin e faturës së muajit nëntor 2022, në vlerën 2.173 lekë.
 - Njoftim debitimi datë 11.01.2023 i Raiffeisen Bank, për pagesat e kryera nga Malvina Dautaj, në favor të UKT Sh.a për pagimin e muajit dhjetor 2022, në vlerën 2.254 lekë.

- Njoftim debitimi datë 07.02.2023 i Raiffaisen Bank, për pagesat e kryera nga Malvina Dautaj, në favor të UKT Sh.a për pagimin e muajit janar 2023, në vlerën 2.219 lekë.
- Njoftim debitimi datë 14.12.2022 i Raiffeisen Bank, për pagesat e kryera nga Malvina Dautaj, në favor të FSHU Sh.a për pagimin e muajit nëntor 2022, në vlerën 5.663 lekë.
- Njoftim debitimi datë 11.01.2023 i Raiffeisen Bank, për pagesat e kryera nga Malvina Dautaj, në favor të FSHU Sh.a për pagimin e muajit dhjetor 2022, në vlerën 9.778lekë.
- Njoftim debitimi datë 07.02.2023 i Raiffeisen Bank, për pagesat e kryera nga Malvina Dautaj, në favor të FSHU Sh.a për pagimin e muajit janar 2023, në vlerën 10.268 lekë.

36.1 **Në e-mailin e datës 07.07.2023**, nga adresa *****, drejtuar Alban Dautaj, në lidhje me informacionin e kërkuar për numrat e telefonit të Alban Dautaj dhe bashkëshortes së tij, ku rezulton se shtetasi Alban Dautaj zotëron numrat 06***** dhe 06***** ka shpenzuar gjatë vitit 2022 shumën 15.554 lekë, ndërsa shtetasja Malvina Dautaj ka të regjistruar numërin 06***** (numëri i cili përdoret për pajisjen HomeNet për shpërndarje interneti) ka shpenzuar gjatë vitit 2022 shumën 25.192 lekë. **Shuma e përgjithshme 40.746 lekë.**

○ Subjekti bashkëlidhi:

- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. **** kol., datë 12.07.2023, sipas së cilës deklaruesi Saliko Dautaj, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “S.S.X” sh.p.k, deklaroi se lidhur me pagimin e shpenzimeve të energjisë elektrike dhe ujit, ato përballohen nga vetë Albani, sipas niveleve të konsumit familjar, duke filluar nga muaji nëntor 2019, kur ka filluar të banojë në apartamentin në fjalë.

36.2 Shpenzimet e deklaruara ujë+drita+telefon+internet, gjatë periudhës së sipërcituar rezultojnë në total 172.000 lekë.

Konkluzion:

36.3 **Trupa e vlerësimit nga rrethanat e faktit, informacionet e mbledhura nga institucionet ligjzbatuese dhe operatorët ekonomik konfirmon përputhshmërinë deklarimet e subjektit në lidhje me shpenzimet dhe vlerën e tyre.**

A/5 Udhëtimet e tre viteve të fundit

❖ **Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike) duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara – Periudha 01.01.2020-31.12.2022.**

- Të gjitha udhëtimet e pasqyruara në sistemin TIMS janë për arsye shërbimi ndaj Policisë së Shtetit (*pjesëmarrje në takim pune, trajnime, konferenca workshope, shërbime Aniterrori*) **Shuma 0 lekë.**
- Shpenzime për udhëtime turistike të bashkëshortes në Ohër Maqedoni e Veriut nga data 30.03.2019 deri në datën 31.03.2019, organizuar dhe sponsorizua nga qendra e punës Banka Raiffeisen sh.a. **Shuma 0 lekë.**

➤ Sipas inventarit me **nr. extra prot., datë 14.07.2023** subjekti i vlerësimit ka dorëzuar:

- Ekstrakt nga sistemi TIMS datë 07.03.2023, për hyrje/daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë së shtetases Malvina Dautaj, ku rezulton se ka dalë nga pika kufitare Qafa e Thanës në datën 30.03.2019 dhe ka hyrë në pikën kufitare Tushemisht në datën 31.03.2019.
- Extrakt nga sistemi Tims, datë 23.02.2023, për hyrje/daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë së shtetasit Alban Dautaj, Urdhërit nr. ***, datë 15.03.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për dërgimin me shërbim jashtë shtetit të Alban Dautaj, për periudhën 14.04.2019-18.04.2019 për arsye pune me :
 - Urdhërin nr. *** datë 10.05.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për dërgimin me shërbim jashtë shteti të Alban Dautaj, për periudhën 23.06.2019-28.06.2019.
 - Urdhërin nr. ***, datë 27.10.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për dërgimin jashtë shtetit të Alban Dautaj për periudhën 03.11.2021-05.11.2021.
 - Urdhërin nr. ***, datë 26.11.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për dërgimin jashtë shtetit të Alban Dautaj për periudhën 1.12.2021-03.12.2021.
 - Urdhërit nr. ***, datë 28.03.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për dërgimin jashtë shtetit të Alban Dautaj për periudhën 31.03.2022-01.04.2022.
 - Urdhërit nr. ***, datë 29.04.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për dërgimin jashtë shtetit të Alban Dautaj për periudhën 15.05.2022-24.05.2022.
 - Urdhërit nr. ***, datë 09.06.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për dërgimin jashtë shtetit të Alban Dautaj për periudhën 26.06.2022-01.07.2022.
 - Urdhërit nr. ***, datë 16.06.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për dërgimin jashtë shtetit të Alban Dautaj për periudhën 21.06.2022-03.06.2022.

Konkluzion:

37 Trupa e vlerësimit në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, në përfundim të analizimit dhe vlerësimit të deklarimit të subjektit, dokumentacionit justifikues, të dhënave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit konstaton se konfirmohet deklarimi i subjektit të vlerësimit në lidhje me kohën e daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe vlerën 0 lekë.

A/6 Arsimi.

❖ **Për arsimin e fëmijëve, madhor apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimi, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore si dhe kohëzgjatjen e studimeve sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32 të ligjit të vlerësimit.**

Subjekti i vlerësimit nuk ka deklaruar shpenzime për arsimim.

38 Relatori i çështjes në e-mailin e datës 31.10.2023, ka kërkuar sqarime nga subjekti i vlerësimit në lidhje me faktin e mosdeklarimit të shpenzimeve për arsim, pasi nga deklarimi ka rezultuar që ka

një fëmijë në moshën 10-vjeçare dhe me kthim-përgjigjen nr. *** prot 10.11.2023 është shprehur se:

- *“Djali im M. Dautaj ndjek arsimin e detyrueshëm në shkollën 9 vjeçare publike ‘Misto Mame’ Tiranë. Për arsimin e djalit nuk kam kryer shpenzime (përveç atyre të zakonshme për mjete didaktike lapsa-fletore) pasi shkolla ‘Minsto Mane’ është pjesë e arsimit parauniversitar publik i cili ofrohet falas nga shteti (përfshirë dhe librat)”*.

Konkluzion:

38.1 Trupa e Vlerësimit konstaton se shpjegimi i subjektit është i mjaftueshëm për të ezauruar faktin se përse nuk janë deklaruar shpenzime për arsim gjatë periudhës së përcaktuar në nenin 32, të ligjit nr. 12/2018 i ndyshuar.

Konstatimet e tjera mbi procesin e vlerësimit.

✚ Në deklaratën e pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti Alban Dautaj ka deklaruar adresën e plotë ku është regjistruar në Gjendjen Civile: *“Njësia Bashkiake nr. **”, rruga “Sitki Çiço” pall. **, shk. **, ap. **. Tiranë*”, si dhe adresën e plotë ku banon: *“rruga, “5 maj” pall. “Vila L”, shk. **, ap. **, Tiranë*.

39 Me email-in e datës 14.07.2023, subjekti sqaroi se adresa: *“Njësia Bashkiake nr. **, Rruga "Sitki Çiço", pallati **, shk. **, ap. **, është banesë e prindërve të tij, dhe se ai nuk ka pronësi mbi të, duke e vërtetuar këtë fakt me certifikatën e pronësise për këtë apartment dhe kontratën e privatizimit nga enti i banesave, në vitin 1993.*

39.1 Sipas inventarit nr. Extra prot., datë 14.07.2023, subjekti ka dorëzuar:

- Certifikatë për vërtetim pronësie nr. *****, lëshuar në datën 15.05.2008, për pasurinë nr. ***, ZK ***, vol. **, fq. ***, ndodhur në rruga. *“Sitki Çiço”*, pall. **, shk. **, ap. **, Tiranë, në bashkëpronësi të Saliko, Bajame dhe Sajmir Dautaj.
- Kontratë për privatizimin e banesës datë 01.09.1993, lidhur ndërmjet NK Banesa dhe Saliko Dautaj, për privatizimin e banesës i ndodhur në rrugën. *“Sitki Çiço”*.
- Kontrate shitblerie datë 04.07.1994, lidhur ndërmjet NK Banesa dhe Saliko Dautaj, B. D, K. D dhe S. D, për shitjen e apartamentit në rrugën *“Sitki Çiço”*, me sip. 89m2,
- Vendim nr. *** datë 27.02.2008 i Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tiranë, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare të të ndjerës K. Dautaj, duke caktuar si trashëgimtar testamentar të saj të birin Saliko Dautaj i cili trashëgon të gjithë pasurinë e paluajtshme të saj si dhe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej saj.

Konkluzion:

39.2 Trupa e vlerësimit në zbatim të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, në përfundim të analizimit dhe vlerësimit të deklaramit të subjektit, dokumentacionit justifikues, konstaton se deklarimi i subjekti të vlerësimit, në lidhje me adresën dytësore të deklaruar është në përputhje me rrethanat e faktit.

✚ **Intesa SanPaolo Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 25.05.2023, konfirmon se Alban Dautaj ka qënë autorizuar në llogaritë e “S.S.X” sh.p.k,

40. Në lidhje me faktin e sipërpërmendur në zhvillim të hetimit të plotë administrative ka kërkuar nga subjekti i vlerësimit në e-mailin e datës 31.10.2023², shpjegime në lidhje me faktin që për periudhën 2005-2008, ka qënë i punësuar pranë Policisë së Shtetit.

40.1 Subjekti i vlerësimit me kthim-përgjigjen nr. *** prot., datë 10.11.2023 ka dhënë shpjegime si më poshtë vijon:

- “Rreth viteve 2003 - 2007, kam qënë person i autorizuar në llogarinë e “S.S.X” sh.p.k., pranë Bankës Intesa, nga babai im administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë, i cili në atë periudhë ka pasur një pamundësi fizike. Në janar të vitit 2007 jam larguar si person i autorizuar firmës.
- Theksoj se, une nuk e kam ushtruar asnjëhere efektivisht detyrën e Administratorit dhe s'kam qënë i punësuar pranë shoqërisë “S.S.X” sh.p.k, gjatë periudhës shkurt 2003 - janar 2008 e cila përfshin edhe periudhën 16.08.2005 - 31.01.2008 si punonjës në Policinë e Shtetit.
- Duke mos e ushtruar efektivisht detyrën e administratorit dhe duke mos qënë në dijeni që kisha mbetur në regjistrat tregtar si i tille, unë s'kam qënë në kushtet e ndonjë veprimtarie që të më pengonte në plotësimin e kërkesave të detyrës në Policinë e Shtetit. Duke mos qënë i dy punësuar nuk kisha as arsyse të njoftoja eprorin dhe të merrja miratimin paraprak të tij, sipas pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr. 8553 datë 25.11 1999 “Për Policinë e Shtetit”.
- Sa lidhet me emërimin tim si administrator tek shoqëria “S.S.X” sh.p.k, sqaroj se, emërimi im në detyrën e drejtuesit administrativ, është berë në vitin 2003 përpara se unë të emërohesha në detyrën e punonjësit të policisë se shtetit. Ky emerimi është berë për të përballuar një rast urgjence të një pamundësie fizike të babait tim në atë periudhë por ky emerim nuk u ekzekutua kurrë, pasi nuk lindi e nevojshme. Emërimi në fjalë ka mbetur i fjetur në regjistra, deri sa ne fund të dhjetorit 2007 regjistri tregtar u transferua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë tek QKR-ja (sot QKB) duke u bërë publik dhe lehtësisht i aksesueshëm, në vijim të të cilit u evidentua dhe u bë dhe aplikimi për heqjen.
- Gjatë gjithë periudhës në fjalë detyrën e administratorit e ka ushtruar vetë babai im Saliko Dautaj i cili është ortak dhe administrator i vetëm i shoqërisë qysh prej themelimit të saj në vitin 1993 dhe deri me sot. *(Qoftë vendimi për emërim dhe kërkesa për regjistrim për emërim në*

² Nga të dhënat e hetimit të deri tanishëm rezulton se në periudhën ndërmjet viteve 2003-2008 keni qënë administrator i shoqërisë “S.S.X” sh.p.k ndërkohë që në vitin 2005 jeni bërë pjese e Policisë së Shtetit si punonjës i saj. Referuar legjislacionit në fuqi në momentin e krijimit të marrëdhënies suaj të punës, pika 2 e nenit 50 i ligjit nr. 8553 datë 25.11 1999 “Për Policinë e Shtetit” parashikon “Në rastet e dypunësimit, punonjësi i Policisë, paraprakisht, njofton eprorin, i cili bën vlerësimin sipas pikës 1 të këtij neni. Mosmarrëveshjet zgjidhen nga titullari i organit përkatës”

-Për periudhën 2005-2008 kërkojmë nga ana juaj informacion dhe dokumentacion shoqërues në lidhje me lejimin e ushtrimit të kësaj detyre si administrator i shoqërisë “S.S.X” sh.p.k kur keni qënë njëkohësisht edhe punonjës policie.

gjykatë qoftë vendimi për largimin, qoftë kërkesa drejtuar QKR-së janë bërë nga ortaku i vetëm dhe administratori i Shoqërisë Saliko Dautaj dhe jo prej meje).

Bashkëlidhur kthim-përgjigjes subjekti i vlerësimit pasqyroj:

- Deklaratë noteriale datë 09.11.2023, të lëshuar nga Administratori dhe Ortaku i Vetëm i Shoqërisë “S.S.X” sh.p.k., Saliko Dautaj.
- Listepagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore të Shoqërisë “S.S.X” sh.p.k, për periudhën qershor 2005-janar 2008.

40.2 Trupa e vlerësimit nga verifikimi i dokumentacionit të Sigurimeve Shoqërore konstatoj faktin se në asnjë muaj, brenda periudhës 2003-2008, nuk është kryer asnjë pagesë apo të jenë paguar kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ne emër të subjektit të vlerësimit z. Alban Saliko Dautaj.

40.3 Në deklaratën noteriale që mban datën 09.11.2023, të lëshuar nga Administratori i Shoqërisë “S.S.X” sh.p.k, si dhe listëpagesën e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit rezultoj fakti që administratori i shoqërisë z. Saliko Dautaj në asnjë moment nuk është larguar nga detyra e administratorit të shoqërisë.

Konkluzion:

40.4 Trupa e vlerësimit gjykon se referuar faktit se subjekti i vlerësimit nuk e ka ushtruar në asnjë moment detyrën e administratorit, vërtetuar ky fakt me të dhënat e vëna në dispozicion nga subjekti i vlerësimit, nuk përbejnë kusht për penalizimin e subjektit të vlerësimit.

✚ **Tirana Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Alban Dautaj ka pasur llogari në monedhën lekë, aktive për periudhën 2010 - 2013, ku nuk rezultojnë veprime në llogari.

✚ **Raiffeisen Invest**, me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se Alban Dautaj ka investuar në Fondin Prestigi për periudhën 09.08.2021 - 19.10.2022, shumën e përgjithshme 26.000 lekë me fitim/humbje 0 lekë. Malvina Dautaj ka investuar në Fondin Pension, për periudhën 26.05.2015-14.09.2020, shumën e përgjithshme 64.000 lekë. Gjthashtu, konfirmon se Malvina Dautaj ka investuar në Fondin Prestige, për periudhën 22.06.2015-10.10.2022, shumën e përgjithshme 1.960.176 lekë, me fitim 58.230 lekë, ku në datën 20.04.2017 është investuar shuma 1.500.000 lekë.

41. Me e-mailin e datës 14.07.2023, subjekti sqaroi lidhur me fitimet e realizuara se ka qenë një pasaktësi kjo nga ana e tij, në mënyrën si e ka konceptuar për ta deklaruar, por jo me qellim për të mos deklaruar. Subjekti sqaroi se ka menduar se në momentin që te fondi i investimit kalojnë dhe fitimet sipas viteve përkatëse, këto automatikisht janë pasqyruar në balancat e fund vitit në llogari dhe se kjo shumë (shuma fillestare + fitimet) kanë lënë gjurmë në transaksionet e kryera nga ky fond. Subjekti sqaroi se shuma e fondit pas tërheqjes është përdorur për shpenzime të rregullimit të shtëpisë duke përfshirë mobilimin.

Pasuria nr. 1

- ❖ Automjet në pronësi me targë A*****, i llojit Ford Fusin, blerë në datën 09.11.2020. **Vlera:** 126.000 lekë. **Pjesa takuese:** 100% **Burimi i krijimit:** Të ardhura nga paga në shumën 126.000 lekë. **Shënime:** Kursime nga të ardhurat nga paga ndër vite.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor, lëshuar në datën 09.11.2020, nga DPSHTRR, për automjetin me targë A*****, të llojit Ford Fuison, blerë me faturë nr. *** datë 09.11.2020, në pronësi të Malvin Dautaj.

Hetimi i trupës së vlerësimit:

- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor**, me shkresën nr. **** prot., datë 10.05.2023, konfirmon se Malvina Dautaj ka të regjistruar automjetin me targë A****, blerë me kontratë shitje automjeti me datë 09.11.2020 dhe faturë tatimore shitje nr. **, datë 09.11.2020 në vlerën 126.000 lekë. Pasuria është përfituar me kontratë blerje dhe faturë tatimore shtitje viti 2020.

- 42. Trupa e vlerësimit**, gjatë hetimit administrativ në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie ka analizuar llogaritë bankare të pagës dhe të kursimeve të personit të lidhur rezulton me mundësi kursimi për blerjen e kësaj pasurie.

Konkluzion:

- 42.1 Trupa e vlerësimit në përfundim të hetimit, bazuar në rrethanat e faktit, dokumentacionin e administruar si dhe referuar verifikimit të llogarive bankare konstaton se përputhet deklarimi i subjektit të vlerësimit dhe ligjshmëria e burimit të krijimit.**

Pasuria nr. 2

- ❖ Llogari individuale page pranë Raiffeisen Bank me nr. ***** Gjendja e balancës në datën 14.02.2023. **Vlera:** 0 lekë. **Pjesë takuese:** 100% **Burimi i krijimit:** Të ardhura nga paga

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie datë 04.10.2018 nga Raiffeisen Bank, të Malvina Dautaj, për periudhën 26.11.2014-30.03.2018. Gjendja në llogari në 30.03.2018 me vlerë: -130.315 lekë.
- Nxjerrje llogarie datë 14.02.2023 nga Raiffaisen Bank, të Malvina Dautaj për periudhën 10.04.2018-28.06.2022. Gjendja në llogari në 28.06.2022, me vlerë 0 lekë.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Malvina Dautaj ka llogari page me gjendje në datën 07.03.2023, me vlerë: 0 lekë.

43. Trupa e vlerësimit gjatë hetimit të kryer ka kontrolluar llogaritë e pagës, së personit të lidhur duke verifikuar derdhjet nëqoftëse këto përkojnë me kreditimin e pagës nga punëdhënësi.

✓ **Trupa e vlerësimit pas verifikimit të kryer konfirmon deklarin e personit të lidhur mbi këtë pasuri.**

Pasuria nr. 3

❖ Llogari individuale në euro pranë Raiffeisen Bank, me nr. *****. Gjendja e balancës në datën 14.02.2023. **Vlera:** 0 euro. **Pjesë takuese:** 100%. **Burim krijim:** Kursimet personale ose pagesa të ndryshme.

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. **** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Malvina Dautaj ka llogari rrjedhëse në euro me gjendje në datën 07.03.2023 me vlerë 0 euro.

✓ **Trupa e vlerësimit pas verifikimit të kryer konfirmon deklarimi e personit të lidhur mbi këtë pasuri.**

Pasuria nr. 4

❖ Llogari rrjedhëse individuale në lekë pranë Raiffeisen Bank, me nr. *****. Gjendja e balancës në datën 14.02.2023. **Vlera:** 0 lekë. Pjesë takuese: 100%. **Burim krijim:** Kursimet personale ose pagesa të ndryshme.

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. **** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Malvina Dautaj ka llogari rrjedhëse në lekë me gjendje në datën 07.03.2023 me vlerë 126 lekë.

✓ **Trupa e vlerësimit pas verifikimit të kryer konfirmon deklarimi e personit të lidhur mbi këtë pasuri.**

Pasuria nr.5.

❖ Llogari individuale kursimi pranë Raiffeisen Bank me nr. ***** Raiffeisen Vizion. Data e fillimit: 18.08.2022. Gjendja e balancës në datën 14.02.2023. **Vlera:** 7.255 lekë. **Pjesë takuese** 100%. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga pagan në shumën 1.000 lekë/muaj. **Shënime:** Kursime personale nga paga.

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon nga nxerrjet e llogarisë së Malvina Dautaj ka kryer transferta periodike, për periudhën 27.07.2022-27.02.2023, në vlerën 1.000 lekë në muaj, për një shumë të përgjithshme deri në datën 07.03.2023 në vlerën 8.000 lekë.

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Malvina Dautaj ka investuar në Fondin Raiffeisen Vizion, që prej datës 27.07.2022 e në vazhdim, me gjendje në 07.03.2023 në vlerën 8.333 lekë.
- ✓ **Trupa e vlerësimit pas verifikimit të kryer konfirmohet deklarimi i personit të lidhur mbi këtë pasuri.**

A/7 DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- ❖ Personi i lidhur bashkëshortja e subjektit të vlerësimit në rubriken e të ardhurave ka deklaruar në rend kronologjik të ardhurat e përfituara nga punësimi:
 - Të ardhura nga paga si asistente financiare pranë shoqërisë “S.S.X” sh.p.k, për periudhën prill 2011- tetor 2014. Shuma 722.120 lekë.
 - Të ardhura nga paga si punonjëse e Bankës Raiffeisen Bank, për periudhën nëntor 2014-janar 2023. Shuma 6.716.524 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie datë 04.10.2018, nga Raiffeisen Bank, të Malvina Dautaj, për periudhën 26.11.2014-30.03.2018, ku rezulton se ka përfituar të ardhura në shumën 2.962.294 lekë. Gjendja në llogari në datën 30.03.2018, me vlerë -130.315 lekë.
- Nxjerrje llogarie datë 14.02.2023, nga Raiffeisen Bank, të Malvina Dautaj, për periudhën 10.04.2018-28.06.2022, ku rezulton se ka përfituar të ardhura në shumën 3.556.457 lekë. Gjendja në llogari në datën 28.06.2022, me vlerë 0 lekë.
- Nxjerrje llogarie datë 24.04.2018, nga Banka Kombëtare Tregtare, të Malvina Dautaj, për periudhën 01.03.2012-28.01.2016, ku rezulton se ka përfituar të ardhura në shumën 475.738 lekë. Gjendje në llogari në datën 28.10.2016, në vlerën 0 lekë.

Hetimi i trupës së vlerësimit:

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023 konfirmon nga nxjerrja e llogarisë së Malvina Dautaj se ka përfituar të ardhura nga paga dhe shpërblime për periudhën nëntor 2014-shkurt 2023 në shumën 6.824.597 lekë. Gjithashtu, konfirmon nga nxjerrja e llogarisë së Malvina Dautaj ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën qershor 2011-maj 2013, në shumën 185.000 lekë dhe kreditimin në datën 21.12.2011 të shumës 221.742, nga “S.S.X” sh.p.k, me përshkrimin “paga prill-dhjetor 2011”.
- ✚ **Banka Kombëtare Tregëtare**, me emailin e datës 29.06.2023, konfirmon nga nxjerrjet e llogarisë së Malvina Dautaj, ka përfituar nga paga për periudhën shkurt 2012- nëntor 2014, në shumën 500.376 lekë.

✚ **Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresën nr. *** prot., datë 10.05.2023, konfirmon se Malvina Dautaj, ka realizuar të ardhura nga punësimi, për periudhën janar 2012- qershor 2012 dhe shtator 2012-tetor 2014, nga “S.S.X” sh.p.k, për periudhën qershor 2012- gusht 2012 nga EOS Albania, për periudhën nëntor 2014- mars 2023 nga Raiffeisen Bank sh.a.

44. Trupa e vlerësimit konstaton, se personi i lidhur bashkëshortja znj. Malvina Dautaj, ka kryer deklarinimin e të ardhurave ndër vite, në zbatim të nenit 32, të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar.

Konkluzion:

44.1 **Trupa e vlerësimit nga verifikimi i kryer ka konstatuar përputhshmëri mbi deklarimin e të ardhurave të pasqyruara nga personi i lidhur në deklaratën e pasurisë dhe të dhënat e mbledhura nga institucionet ligjzbatuese dhe bankat e nivelit të dytë.**

A/8 DETYRIME FINANCIARE

Detyrimi nr.1

❖ Bashkëkredimarrëse i një kredie bankare me hipotekë pranë Raiffeisen Bank sh.a në vlerën 4.000.000 lekë, me kohëzgjatje nga 02.04.2021 deri në 02.04.2041, me këste 16.700 lekë. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer 3.634.061 lekë.

Shënim: Kredia është marrë për shlyerjen e një kredie tjetër dhe për arredim shtëpie banimi. Kontratë Kredie Bankare nr. **** rep., nr. *** kol., datë 15.03.2021. **Trajtuar me sipër.**

Detyrimi nr. 2

❖ **Kredi bankare personale pranë Raiffeisen Bank sh.a.**, në vlerën 1.500.000 lekë me kohëzgjatje nga data 04.01.2023 deri në 04.01.2030, me këste 19.454 lekë. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur pa shlyer 1.483.001 lekë. Shënim: Kredia është marrë për shlyerjen e kredive të tjera dhe shpenzime familjare. Kontratë Kredi Konsumatore datë 04.01.2023.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë kredie konsumatore datë 04.01.2023, lidhur nëpërmjet Raiffeisen Bank sh.a dhe Malvina Dautaj, për kredinë në vlerë 1.500.000 lekë, me qëllim “për arsye personale”

Hetimi i trupës së vlerësimit.

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se në emër të Malvina Dautaj rezulton:

- Kredi e disbursuar në datën 04.01.2023, me reference **** në vlerën 1.500.000 lekë, me gjendje detyrimi në datën 07.03.2023 në vlerën 1.466.784 lekë.

- ✚ Nga nxjerrjet e llogarisë së Malvina Dautaj, në datën 04.01.2023, rezulton transaksioni në vlerën 1.074.125 lekë me përshkrim "*pagese principale kredie*" me referencë *****, në datën 04.01.2023, rezulton transaksioni në vlerën 113.595 lekë, me përshkrim "Malvina Dautaj Hair" me referencë *****.

Gjithashtu, rezultojnë:

- Kredi e disbursuar në 31.05.2021, me referencë *****, në vlerën 200.000 lekë.
- Kredi e disbursuar në 26.8.2021, me referencë *****, në vlerën 500.000 leke, përdorur shuma 189.148 lekë, për shlyerjen e kredisë me referencë *****.
- Kredi e disbursuar në 17.11.2021, me referencë *****, në vlerën 119.990 lekë.
- Kredi e disbursuar në 11.01.2022, me referencë *****, në vlerën 600.000 lekë, përdorur shuma 477.911 lekë për shlyerjen e kredisë me referencë *****, dhe shuma 113.516 lekë për shlyerjen e kredisë me referencë *****.
- Kredi e disbursuar në 06.06.2022, me referencë *****, në vlerën 750.000 lekë, përdorur shuma 566.033 lekë për shlyerjen e kredisë me referencë *****.
- Kredi e disbursuar në 01.08.2022, me referencë *****, në vlerën 124.990 lekë.
- Kredie disbursuar në 10.10.2022, me referencë *****, në vlerën 1.100.000 lekë, përdorur shuma 716.840 lekë për shlyerjen e kredisë me referencë *****.

45. Me e-mailin e datës 14.07.2023, lidhur me objektin e kredisë, subjekti sqaroi se në termat bankare për kredite e pasiguruara (pa kolateral) qëllimi konsiderohet personal dhe se fondet e marra nga kredia janë përdorur për mbylljen e detyrimeve të tjera në bankë dhe për përdorime familjare sipas nevojave, pasi për këto lloj kredish nuk ka kushtëzim përdorimi.

45.1 Trupa e vlerësimit ka verifikuar nëpërmjet llogarive bankare të personit të lidhur, kalimin dhe disbursimet e kredive të marra në mënyrë vazhduese, si dhe ka analizuar faktin e mundësisë së pagimit të kështit të kredisë për periudhat vazhduese, nga ku ka rezultuar se ka pasur mundësi financiare për shlyerjen e tyre.

Konkluzion:

45.2 Trupa e vlerësimit konstaton se **përputhet deklarimi personit të lidhur me rrethanat e faktit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjekti i vlerësimit dhe bankat e nivelit të dytë si dhe konfirmon mundësinë e pagesave të kësteve të kredisë nga ana e personit të lidhur.**

- ✚ **Nëpërmjet hetimit të zhvilluar kryesisht trupa e vlerësimit**, në zbatim të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, me shkresën nr. **** prot., datë 11.09.2023 kërkoj nga Regjistrit Noterial pranë Ministrisë së Drejtësisë informacion në lidhje me aktet e kryera nga subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, ku me kthim-përgjigjen nr. *** datë 12.10.2023 nuk konfirmohen veprim të kryera të pa deklaruar nga subjekti i vlerësimit.

- ✚ **Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit mbi personin tjetër të lidhur babain e subjektit të vlerësimit z. Saliko Dautaj.**

42. Trupa e vlerësimit në zbatim të neneve 32-34 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, ka kryer hetim mbi mundësit financiar të personit tjetër të lidhur, babait të subjektit të vlerësimit, mbi krijimin e pasurisë që posedon subjekti i vlerësimit. Marrëdhënia financiare e krijuar ndërmjet subjektit të vlerësimit dhe personit të lidhur ka për objekt “dhënien në përdorim” të apartamentit të banimit me sipërfaqe 119.31 m², i ndodhur në Njësine Bashkiake nr. ***, rruga “5 maji”, Tiranë, në pronësi të shoqërisë “S.S.X” sh.p.k.³.

42.1 **Qendra Kombëtare e Biznesit**, me shkresën nr. **** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Saliko Dautaj figuron si aksioner në subjektin “Stofrat e Holla” sh.a me Nip-t J*****, me status aktiv si dhe administrator dhe ortak me 100% të kapitalit në subjektin “S.S.X” Shpk me nr Nipt J*****, me status aktiv i pajisur me licencë nr. LN ***** për sigurimin fizik të objekteve shtetërore e private, i personave si dhe veprimet social-kulturore, fetare e politike.”

42.2 **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve**, me shkresën nr. ***, datë 11.05.2023, konfirmon se Saliko Dautaj figuron në organet tatimore, për ushtrim të aktivitetit privat si Administrator dhe aksioner në shoqërinë “S.S.X” sh.p.k., si dhe aksioner në shoqërinë “Stofrat e Holla” sh.a.

42.3 Trupa e vlerësimit, referuar të dhënave të administruara dhe në vlerësim të faktit, gjykon se hetimi mbi personin tjetër të lidhur do të shtrihet vetëm mbi veprimtarinë si ortak dhe aksioner i vetëm i shoqërisë “S.S.X” sh.p.k, për arsye se ka rezultuar ndërveprim midis subjektit të vlerësimit dhe ortakut të kësaj shoqërie. Në lidhje me veprimtarinë si aksioner “Stofrat e Holla” sh.a me Nipt J***** me status aktiv, trupa e vlerësimit e konsideron si të panevojshëm kryerjen e hetimit pasi nga verifikimi i rrethanave nuk rezulton asnjë veprim midis subjektit të vlerësimit dhe kësaj shoqërie tregëtare.

43. Trupa e vlerësimit referuar akteve të listuara në pikën 24.1 të këtij relacioni dhe trajtimit të bërë mësipër mbi pronësinë dhe mënyrën e krijimit të saj e konsideron të ezauruar hetimin në lidhje me marrëdhënien e subjektit të vlerësimit me personin tjetër të lidhur, (marrëdhënie babë e bir).

44. Mbi personin e lidhur Saliko Dautaj janë kryer verifikime në institucionet ligjzbatuese të Republikës së Shqipërisë në kuadër të kontaktit të papërshtatshëm nga ku ka rezultuar se në ngarkim të shtetasist Saliko Dautaj nuk figurojnë të dhëna/informacione në ngarkim për përfshirje në veprimtari kriminale.

✓ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e

³ Nëpërmjet ekstraktit historik vërtetohet fakti shoqëria S.S.X shpk ka ortak dhe administrator të vetëm z. Saliko Dautaj, babai i subjektit të vlerësimit

kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit:

- **Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- **Nuk është kryer deklaram i rremë;**
- **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

B. KONTROLLI I FIGURËS

✚ Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

45. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

- ✚ të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- ✚ raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
- ✚ verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërmra (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

46. Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit z. Alban Dautaj me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë së deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

✚ **Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”;
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
- c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë.

✚ Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore si organ ndihmës, në përputhje me nenin 42 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar,

për vlerësimin e kontrollit të figurës ka dorëzuar nëpërmjet shkresës nr.*** datë 20.07.2023 raportin e kontrollit të figurës⁴ ku ka konstatuar se:

❖ **Subjekti i vlerësimit z. Alban Saliko Dautaj, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Antiterrorit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.**

❖ **Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:**

- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.
- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka patur apo ka regjistruar në gjendjen civile.
- Nuk ka pasur apo ka shtetësi tjetër.
- Nuk ka qenë asnjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale ndaj tij.
- Nuk ka qenë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.

⁴ Raporti mbi kontrollin e figurës nr. ***** datë 20.07.2023

- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike.
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish -shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

47. Në mbështetje të neneve 35-42 të ligjit nr 12/2018 i ndryshuar trupa e vlerësimit zhvilloj hetimin mbi kontrollin e figurës duke u bazuar në kthim-përgjigjet e institucioneve ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, raportin e Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit dhe deklaratimet e subjektit të vlerësimit **nga ku u konstatua nga :**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën “I kufizuar” nr. **** prot., datë 25.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Alban Saliko Dautaj bën me dije se:

- a. Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve
- b. Nuk ka ndryshuar shtetësi (lenie ose marrje shtetësie)

2. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën “I kufizuar” nr.**** prot ., datë 19.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Alban Dautaj bën me dije se:

- a. Nuk rezulton i dënuar.

3. Institucion ligjzbatues, me shkresën “Sekret” nr. **** prot., datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Alban Saliko Dautaj si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare bën me dije se:

- a. Nuk kanë të dhëna në lidhje me cenimin e sigurisë kombëtare apo aktivitete të kundraligjshme.

4. Institucion ligjzbatues, me shkresën “I kufizuar” nr. **** prot., datë 26.05.2023, dhe shkresë “E paklasifikuar” nr.**** prot., datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Alban Saliko Dautaj si dhe për personat e lidhur sipas certifikatës familjare **nuk kanë:**

- a. Të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimin e ngritur në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
- b. Të dhëna për kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar (*sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*) ku mund të përfshihen biseda, foto, vëzhgime takimesh apo biseda telefonike etj;
- c. Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (*të dënuar ose proceduar penalisht, brenda apo jashtë territorit të republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr 10192 datë 03.12.2009 “për parandalimin dhe goditjen e krimit*

të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë i ndryshuar.);

- d. Të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- e. Të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e ndonjë vepre penale.
- f. Të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhër arresti ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
- g. Të dhëna në lidhje me ndonje masë debimi nga një shtet i huaj;
- h. Të dhëna për gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s.
- i. Të dhëna që nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet
- j. Nuk ka procedime disiplinore apo masa disiplinore në ngarkim të subjektit të vlerësimit.

5. Institucion ligjzbatues, me shkresën “Konfidencial” nr. ***prot., datë 31.05.2023., për subjektin e vlerësimit z. Alban Dautaj bën me dije se:

- a. Nuk disponon të dhëna

6. Institucion ligjzbatues, me shkresë “Sekret” e datës 13.06.2023 dhe shkresën nr.*** prot., datë 19.06.2023, për subjektin e vlerësimit z. Alban Dautaj dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare bën me dije se:

- a. Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të paligjshëm;
- b. Nuk ka precedent penal të referuar

7. Institucion ligjzbatues, me shkresën “I kufizuar” nr.*** prot., datë 26.05.2023 për subjektin e vlerësimit:

- a. Nuk administrohen ankesa, të dhëna ose informacione.

8. Institucion ligjzbatues, me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot., datë 27.06.2023 për subjektin e vlerësimit z. Alban Saliko Dautaj bën me dije se:

- a. Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;
- b. Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal;
- c. Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo presonit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34, të Kodit të Procedurës Penale;
- d. Nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprës penale;
- e. Nuk ka pasur raste të urdhërit ndërkombëtar të ndalimit.

9. Institucion ligjzbatues, me shkresën “I kufizuar” nr.**** prot., 01.06.2023 bën me dije se, për subjektin e vlerësimit z. Alban Saliko Dautaj:

- a. Nuk rezulton të jetë regjistruar procedimi penal.

10. Institucion ligjzbatues, me shkresën “Sekret” nr **** prot., datë 25.05.2023 bën me dije se:

- a. Nuk rezultuan raportime për subjektin e vlerësimit Alban Saliko Dautaj dhe personat e lidhur me të, Malvina Dautaj, M. Dautaj.

11. Institucion Ligjzbatues, me shkresën ‘I kufizuar’ nr.**** prot., datë 19.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Alban Dautaj bën me dije se:

- a. Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), niveli i klasifikimit “Tepër Sekret”, me datë lëshimi 18.01.2022, të vlefshme deri në datën 17.01.2027.
- b. Për subjektin e vlerësimit nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.
- c. Nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

12. Avokati i Popullit, me shkresën “e paklasifikuar” me nr.**** prot., datë 30.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Alban Dautaj bën me dije se:

- a. Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës;
- b. Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

13. Autoriteti për Informacionin mbi Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën “ I kufizuar nr.*** prot., datë 08.06.2023 për subjektin e vlerësimit z. Alban Saliko Dautaj, bën me dije se:

- a. Për shkak të moshës së tij nën 14 vjeç para Korrikut 1991, nuk është subjekt verifikimi sipas përcaktimin të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për Dokumtet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

48. Denoncime nga publiku.

Për subjektin e vlerësimit z. Alban Saliko Dautaj nuk është disponuar asnjë ankese nëpërmjet portalit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për denoncime nga publiku për subjektet e vlerësimit kalimtar dhe periodik.

49. Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndevë narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh

narkotike, nr. ****prot., datë 06.12.2023 “Akt ekspertimi” konkludohet se subjekti vlerësimi z. Alban Dautaj.

- Aktualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.

✓ **Në përfundim të hetimit të kryer për kontrollin e figurës:**

Trupa e vlerësimi pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimi Alban Dautaj, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimi në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, vlerësimi të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimi z. Alban Saliko Dautaj:

- *Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;*
- *Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

50. Objekt i vlerësimi të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimi, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

51. Analiza ligjore e raportit të vlerësimi të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- ✚ të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimi në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- ✚ raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

52. Subjekti i vlerësimi z. Alban Dautaj në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e “Drejtorit të Antiterrotit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Periudha e vlerësimi në zbatim të nenit 44 pika 2 të ligjit 12/2018 i ndryshuar është periudha 5-vjeçare (2018-2023). Procesi i vlerësimi të aftësive profesionale do të shrihet brenda këtij harku kohor.

C/1 RAPORTI I VLERËSIMIT PROFESIONAL POLICIA E SHËTETIT.

53. Struktura e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, ka dorëzuar nëpërmjet shkresës nr.*** prot., datë 05.07.2023 raportin e vlerësimit profesional është shprehur me konkluzion përfundimtar si vijon:

❖ **Punonjësi i Policisë z. Alban Saliko Dautaj është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban.**

C/2 HETIMI I TRUPËS SË VLERËSIMIT:

54. Struktura e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, ka dorëzuar nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 05.07.2023 raportin e vlerësimit profesional.

✚ Punonjësi i Policisë Kryekomisar Alban Saliko Dautaj, është i emëruar në detyrë Drejtor në Drejtorinë e Antiterrorit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me urdhërin nr. *** datë 18.10.2021. Në zbatim të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, funksioni që mban z. Dautaj e bën atë subjekt të ligjit sipas nenit 6.

Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në :

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit nr. ***;
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS me nr. RMIS ****;
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1, të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar.
- Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi performancën e subjektit.

55. Vlerësimi i nivelit të arsimit.

Sipas të dhënave të administruara nga dosja personale e subjekti, rezulton se ka përfunduar arsimin e lartë

Niveli i arsimit	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundimi	Vendi	Titulli/Diploma
3 vjeçare	Akademia e Policisë	2002	2005	Tiranë	Diplomë

- Trupa e vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, administroi nga dosja e subjektit të vlerësimit diplomën me nr. regjistri ****, datë 18.07.2005, ku ka marrë edhe titullin “Specialist i Lartë i Policisë”.
- Në kuptim të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti përmbush kriterin e nivelit, arsimor për funksionin që mban pranë Policisë së Shtetit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

56. Certifikatat e trajnimeve, kualifikimet dhe medaljet:

Trupa e vlerësimit në zbatim të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, gjatë hetimit ka konstatuar se për periudhën 5-vjeçare të vlerësimit subjekti i vlerësimit ka deklaruar se ka marrë pjesë në:

- Trajnim me temë “Për aspektet e punës me informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, datë 27.02.2018 organizuar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit.
- Certifikatë për pjesëmarrje në seminarin e përbashkët mbi “Rritjen e aftësive teknike dhe hetimore të nëjsive të hetimit të antiterrorit”, për periudhën 03-05 prill 2018 organizuar nga Pameca V dhe Policia e Shtetit.
- Kurs hetimi për “Hetimin ndërkombëtar pas Shpërthimit” për periudhën 27 Gusht 2018 - 07 Shtator 2018 organizuar nga International Law Enforcement Academy ILEA Budapest.
- Certifikatë për fitimin e gradës “Kryekomisar” zhvilluar në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit prej datës 14.01.2019-28.01.2019.

56.1 Trupa e vlerësimit, pas administrimit të dosjes së personelit, të subjektit konfirmon pjesëmarrjen e subjektit të vlerësimit në trajnime dhe kualifikime e deklaruara si dhe konstaton se trajnimet e kryera nga subjekti i vlerësimit janë të nevojshme dhe në përputhje me funksionin që ushtron.

57. Pjesëmarrja në konferenca shkencore

57.1 Subjekti i vlerësimit gjatë periudhës 5-vjeçare objekt vlerësimi sipas nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar:

- me urdhërin nr. *** prot., datë 29.03.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ka marrë pjesë në workshopin bilateral për udhërrëfyesin e procesit screening mbi udhërrëfyesin e kapitullit 24 organizuar nga BE.

57.2 Trupa e vlerësimit ka konstatuar se subjekti i vlerësimit, në formularin e deklarimit të aftësive profesionale ka listuar të tjera pjesëmarrjen në konferenca shkencore që i përkasin periudhës përpara 5-vjeçarit të vlerësimit, të cilat janë verifikuar nga trupa e vlerësimit, por nuk janë vlerësuar në funksion të objektit të vlerësimit të aftësinë profesionale duke qenë se nuk i përkasin periudhës së vlerësimit, në zbatim të nenit 44, të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar.

57.3 Trupa e vlerësimit në përfundim të hetimit konstaton se subjekti i vlerësimit ka realizuar pjesëmarrje në konferenca shkencore në përputhje me funksionin që mban.

58. Vlerësimet e punës:

Për periudhën e vlerësimit 5 vitet e fundit (2018-2023), në dosjen e subjekti të vlerësimit dhe në raportin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për subjektin janë pasqyruar vlerësimet e punës si më poshtë vijon:

- Për vitin 2018 me rezultat 28 pikë (shumë mirë)
- Për vitin 2019 me rezultat 28 pikë (shumë mirë)
- Për vitin 2020 me rezultat 28 pikë (shumë mirë)
- Për vitin 2021 me rezultat 28 pikë (shumë mirë)
- Për vitin 2022 me rezultat vlerësim i përgjithshëm 92 pikë nga 100 (shumë mirë).

(Në vlerësimin e mësipërm vlen të theksohet se për periudhën 2018-2021, vlerësimi maksimal i punonjësve sipas formularit të vlerësimit ishtë 28 pikë, ndërsa në vitin 2022 vlerësimi maksimal është 100 pikë)

58.1 Trupa e vlerësimit konstaton se gjatë periudhës objekt vlerësimi subjekti, është vlerësuar maksimalisht “shumë mirë”.

59. Masat disiplinore

Nga verifikimi në dosjen personale si dhe në sistemin RMIS, rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare, (2018-2023) të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, subjekti i vlerësimit nuk ka marrë anjë masë disiplinore.

60. Ecuria në karrierë

Subjekti i vlerësimit Alban Dautaj, ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 17 vitesh e 9 muaj, nga verifikimi i dosjes personale rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare objekt vlerësimit ka:

- **Marrë gradën “kryekomisar”**

Emërtimi i gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr urdhëri	Data	
			Nga	Deri
Komisar	Ngritur në gradë	nr.216 datë 18.01.2011	19.01.2011	06.02.2019
Kryekomisar	Ngritur në gradë	nr.125 datë 07.02.2019	07.02.2019	Aktualisht

60.1 Sa i përket dhënies së gradës policore nga “Komisar” në “Kryekomisar”, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. ***, datë 07.02.2019 “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie”, Trupa e Vlerësimit referuar ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, neni 161/1” pika 1

“Kriteret për aplikim për gradimin e radhës⁵” dhe nenit 161/2 pika 1 “Afatet e qëndrimit në gradë⁶” të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM Nr. 750, datë 16.09.2015 dhe referuar dokumentacionit të gjendur në dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit, Trupa e vlerësimit konstaton se **subjekti ka plotësuar kriteret e percaktuara** në nenin 161/1 të VKM nr. 750, datë 16.09.2015, me qëllim aplikimin për gradën nga Komisar në Kryekomisar.

60.2 Subjekti i vlerësimit ka aplikuar për gradën e radhës duke plotësuar afatet e qëndrimit në gradë konkretisht 8 vite (2011 – 2019) nga 3 vite që parashikon Rregulloria.

60.3 Subjekti i vlerësimit ka përmbushur kriteret e nenit 161 të Rregullores së Policisë së Shtetit për ndjekjen e trajnimit pranë Akademisë së Sigurisë për fitimin e gradës “Kryekomisar”

60.4 Ka përfituar Certifikatën e Trajnimit “Për fitimin e gradës Kryekomisar e zhvilluar në periudhën 14.01.2019-28.01.2019.

60.5 **Trupa e vlerësimit** në përfundim të hetimit të zhvilluar dhe në mbështetje të rrethanave të faktit konstaton se subjekti i vlerësimit ka fituar gradën “**Kryekomisar**” në përputhje me legjislacionin në fuqi duke plotësuar kriteret ligjore.

- **Pozicioni “Drejtor i Antiterrorit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.**

Data e fillimit	Data e përfundimit	Institucioni	Funksioni
19.10.2021	Aktualisht	Drejtoria e Antiterrorit në Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Drejtor i Drejtorisë së Antiterrorit
01.03.2016	19.10.2021	Drejtoria e Antiterrorit në Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Specialist Drejtimi në Sektorin e Hetimit dhe Kordinimit

⁵ Punonjësi i policisë ka të drejtë të aplikojë për fitimin e gradës policore të radhës, kur plotëson kriteret e mëposhtme:

- të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës (të performancës) jo më ulët se 70% të pikëve të vlerësimit të përgjithshëm, gjatë kohës së qëndrimit në gradë;
- të jetë parashkuar masa disiplinore për shkelje të rëndë, sipas afatit të percaktuar në ligjin “Për Policinë e Shtetit”;
- të mos ketë filluar ndaj tij procedimi penal;
- të mos ketë filluar ndaj tij procedimi disiplinor për shkelje të rëndë;
- të ketë plotësuar kohën e qëndrimit në gradë sipas afateve të percaktuara në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.

⁶ Punonjësi i Policisë, për të aplikuar për gradën e radhës, duhet të plotësojë afatet e mëposhtme:

- nga “Inspektor” deri në “Inspektor i dytë”: 5 vjet;
- nga “Inspektor i dytë” në “Inspektor i parë”: 10 vjet;
- nga “Nënkomisar” në “Komisar”: 3 vjet;
- nga “Komisar” në “Kryekomisar”: 3 vjet;
- nga “Kryekomisar” në “Drejtues”: 5 vjet;
- nga “Drejtues” në “Drejtues i parë”: 3 vjet.

61. Trupa e Vlerësimit, referuar pikës 2 të nenit 44 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, konstaton se për periudhën 5 vjecare objekt vlerësimi, z. Dautaj ka ushtruar funksionin e specialistit dhe nga data 19.10.2021 e aktualisht ushtron funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së Antiterrorit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

✓ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit Alban Dautaj;

- **Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- **Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;**
- **Ka vlerësime pozitive pune.**

Konkluzione përfundimtare:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatores së çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 22.02.2024, ftoj subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 01.03.2024, dhe arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, z. Alban Saliko Dautaj, në përputhje me nenin 60, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;*
- *Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.*

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit z. Alban Saliko Dautaj, me funksion Drejtor i Drejtorisë së Antiterrorit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot datë 01.03.2024, në Tiranë.

KRYESUES

ENTON RADOVANI

RELATOR

KLEADA MERSINLLARI

ANËTAR

EDONA DUSHAJ